UDHËZIM
Nr. 4, datë 20.2.2019

PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 14.2.2018, "PËR ORGANIZIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË MATURËS SHTETËRORE 2019", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 3, datë 14.2.2018, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të maturës shtetërore 2019", pika 6 ndryshon si më poshtë:

"Kandidatët, që në Maturën Shtetërore 2012 kanë zgjedhur për të dhënë 3 (tri) provime me zgjedhje dhe kanë mbetur në të tria provimet, të japin vetëm një lëndë nga lista e lëndëve me zgjedhje të këtij udhëzimi. Në rast se rezultojnë kalues në një prej provimeve me zgjedhje dhe nuk janë pajisur me diplomën/certifikatën e maturës, atëherë të pajisen me to".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i MASR-it, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Instituti i Zhvillimit të Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini